



**INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA**

QEVERIA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA

**MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE**

Në përputhje me nenin 23 të Kontratës së Përgjithshme Kolektive, si dhe nenit 2 të Aneksit të kësaj Kontrate,

Duke pasur parasysh Vendimin e Qeverisë numër 02/201 të datës 31.05.2006,

Më qellim të lehtësimit të procedurave për realizimin e të drejtave nga Pushimi i lehonisë,

Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mireqenies Sociale nxjerr këtë:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 06/2006
PËR
RREGULLIMIN DHE PERCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË PAGESËS PËR
PUSHIM TË LEHONISË NË SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**

Neni 1

Qëllimi

Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim të rregulloj dhe të përcaktoj procedurat për realizimin e pagesës dhe të drejtave, gjatë tremujorit të dytë të pushimit të lehonisë për nëpunëset civile në të gjitha organet e punësimit të Shërbimit Civil të Kosovës,

Neni 2

Përfitimet nga pushimi i Lehonisë

(1) Nëpunëset Civile të punësuar në organet e punësimit të Shërbimit Civil të Kosovës, kanë të drejtë në pushim të lehonisë më pagesë në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj,

- (2) Për tre (3) muajt e parë kompensimin e pagesës të pushimit të lehonisë do ta beje punëdhënësi , ndërsa për tre (3) muajt e tjerë të mbetur pagesa do të kompensohet nga Fondi i veçante i krijuar nga Qeveria e Kosovës,
- (3) Të drejtat e tjera gjatë pushimit të lehonisë , të punësuarat në Shërbimin Civil të Kosovës do ti realizojnë në përputhje më dispozitat e nenit 23 të Kontratës se Përgjithshme Kolektive, dhe aktet ligjore e nënligjore të cilat janë të aplikueshme.
- (4) Pagesën e pushimet të lehonisë prej (6) muajve dhe beneficinet e tjera të përcaktuara në nenin 23, të Kontratës se Përgjithshme Kolektive të punësuarat në Shërbimin Civil të Kosovës i realizojnë në mënyrë retroaktive nga data 01.01.2006

Neni 3

Lartësia e kompensimit të pagesës për pushim te lehonisë

- (1) Të punësuarat në Shërbimin Civil të Kosovës , për tre (3) muajt e parë të pushimit të lehonisë do të marrin 70% nga paga e të punësuarës, të realizuar nga punëdhënësi,
- (2) Për tre (3) muajt e tjerë të mbetur të pushimit të lehonisë do te marrin 70% të pagës minimale në Kosove, të përcaktuar nga Këshilli Konsultativ Trepalësh (KKT) i partnerëve social,

Neni 4

Proceduarat Administrative për realizimin e pagesës

- (1) Për realizimin e pagesës dhe beneficioneve të tjera nga pushimi i lehonisë, nëpunëset civile duhet të plotësojnë kërkesën me shkrim e përgatitur nga shërbimi i veçantë i MPMS-së,
- (2) Deri në krijimin e një organi të veçantë, kërkesat duhet dorëzuar në Zyrat rajonale apo komunale të punësimit të cilat janë pjese integrale e DPP të MPMS-së selitë e të cilave janë në të gjitha komunat e Kosovës,
- (3) Shqyrtimin dhe vlerësimin përfundimtar të kërkesës dhe dokumentacionit përkatës për realizimin e pagesës dhe beneficioneve tjera nga pushimi i lehonisë deri në krijimin e një shërbimi të veçantë do ta beje Divizioni i ligjit të punës dhe marrëdhënieve të punës i DPP të MPMS-së,
- (4) Vendimi për njohjen e të drejtës në pagesë dhe beneficioneve të tjera nga pushimi i lehonisë , e nxjerr personi i autorizuar nga Sekretari i Përhershëm i MPMS-së në afatin prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të kerkeses,

Neni 5

Dokumentacioni i nevojshëm për pagesën e pushimit të lehonisë

- (1) Krahas kërkesës me shkrim, për njohje të pagesës dhe të drejtave tjera nga pushimi i lehonisë, nëpunëset civile të Shërbimit Civil të Kosovës duhet të dorëzojnë edhe këto dokumente :
 - Kontratën e punës të nënshkruar nga punëtorja dhe autoritetit i organit të punësimit,
 - Fletëleshimin e spitalit ku ka lindur femiu,
 - Raportin për gjendjen shëndetësore të femiut,
 - Numrin e xhirlogarisë personale në ndonjërin nga bankat e Kosovës,
- (2) Raporti për gjendjen shëndetësore të femiut, i cili konfirmon se femiu është i gjallë duhet të sillet çdo 30 dite, edhe pas dorëzimit të pare me dokumentet e tjera të nevojshme,
- (3) Nëse nëpunësja civile nuk sjell raportin mjekësor çdo 30 ditë, raport ky i cili vërteton se femiu është i gjallë, asaj do ti ndërpritet e drejta në pagesë për pushim të lehonisë,

Neni 6

Aktet e tjera valide për pushimin e lehonisë

Pjese përbërëse e këtij Udhëzimi Administrativ për realizimin e drejt edhe efikas të pagesës së pushimit të lehonisë është edhe vendimi për pagesën e pushimit të lehonisë dhe kërkesa për pagesën e pushimit të lehonisë e plotësuar nga vet punëtorja .

Neni 7

Hyrja ne fuqi

Ky Udhëzimi Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i MPMS-së, ndërsa do të aplikohet në mënyrë retroaktive nga 01.01.2006,

Prishtine , qershor 2006

Ministri i MPMS-së

Ibrahim Selmanaj
